

NE EMËR TE POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Have Haliti kryetare, Fillim Skoro gjyqtar referues e Xhevdet Abazi anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu si procesmbajtës, në lëndën penale kundër te akuzuarit P.N. nga ... komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vrasje e rënde nga neni 179 par.1 nën par 1.1, 1.3 dhe 1.11 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja ne pronësi, kontrole dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore DKR në Gjakovë, të përfaqësuesit të palës së dëmtuar av. I.O. dhe mbrojtësit të akuzuarit av. F.Zh. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Gjakovë PKR.nr.48/18 të dt. 19.11.2018, ne seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt 31.01.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesave të PTH-DKR në Gjakovë dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar ndryshohet, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.48/18,i datës 19.11.2018, përkitazi me cilësimin ligjor dhe vendimin mbi dënimin, dhe Gjykata e Apelit, të akuzuarin P.N. për veprën penale vrasje e rënde nga neni 179 par.1 nën par 1.1, 1.3 dhe 1.11 të KPRK-së, e më afër te përshkruar si ne dispozitivin I. të aktgjykimit e cilëson në veprën penale vrasje e rënde nga neni 179 par. 1 nën par. 1.11 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale i shqipton dënimin me burgim të Përjetshëm, ndërsa për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontrole dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK, më afër te përshkruar si ne dispozitivin II. të aktgjykimit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dhe në bazë te nenit 80 par.2 nën par 2.1 ia shqipton dënimin me burgim të Përjetshëm, e në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt.07.08.2018 e tutje.

II. Ankesa e mbrojtëses të akuzuarit P.N. av. F.Zh. refuzohet si e pa bazuar.

III. Ankesa e të akuzuarit P.N. hudhet poshtë si e pa lejuar.

IV. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-DKR, në Gjakovë PKR .nr. 48/18 të dt. 19.11.2018, të akuzuarin P.N. nga ... komuna e Gjakovës e ka shpallur fajtorë për veprën penale vrasje e rënde nga neni 179 par.1 nën par 1.1, 1.3 dhe 1.11 të KPRK-së, ku është dënuar me burgim ne kohëzgjatje prej 23(njëzet e tre) vite burgim dhe veprën penale mbajtja ne pronësi, kontrole dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK, është dënuar me burgim ne kohëzgjatje prej 2(dy) vite, dhe i është shqiptuar dënimi unik ne kohëzgjatje prej 24 (njëzetekatër) vite burgim, në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 07.08.2018 e deri ne plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Të akuzuarit konform nenit 69 par 1 lidhur me nenin 374 par. 3 të KPRK i është shqiptuar dënimi plotësues, konfiskimi i pushkës automatike të tipit AK- 47 me numër serik 2721-96 të kalibrit 7.62 mm x 39 mm si dhe 30 fishekë të kalibrit të njëjtë, si objekt të kryerjes së veprës penale.

Në kuptim të nenit 450 par . 4 të KPRK, i akuzuari obligohet që te paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 200(dyqind) euro, si dhe ne emër të paushallit gjyqësore shumë prej 200 (dyqind) euro si dhe shumë prej 50 (pesëdhjete) euro në emër te kompensimit të viktimave të krimit, konform nenit 39 par 2 nen par 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 463 par . 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj ne kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore DKR në Gjakovë- për shkak të vendimit mbi dënimin nga neni 387 par 1 të KPPK-së, Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Gjakovë dhe të akuzuarit të ia shqiptoj një dënim me burgim të përjetshëm, me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënitimit.

-Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. I.O. për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, e propozimin që Gjykata Apelit ta aprovojë ankesën e përfaqësuesit të palës se dëmtuar si të bazuar dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Gjakovë ta prishë dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me te lartë ne pajtim me ligjin.

-Mbrojtësja e të akuzuarit P.N. av. F.Zh. për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozimin që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, ashtu që të akuzuarit P.N. për veprat penale për te cilat është shpallur fajtorë, të ja shqipton një dënim me të butë.

-Përgjigje ne ankesë ka paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit P.N. av. F.Zh., dhe ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Gjakovë të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore PKR.nr 48/18 të dt. 19.11.2018 të refuzohet si e pa bazuar.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.15/19 të dt. 04.01.2019 duke u sqaruar përkitazi me ankesat e përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe të mbrojtësit të akuzuarit, ka propozuar që ankesat e Prokurorisë Themelore DKR në Gjakovë dhe e përfaqësuesit të palës se dëmtuar av. I.O. të aprovohen dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit, në bazë të nenit 390 par.1 të KPP, në të cilën morën pjesë i akuzuari P.N., mbrojtësi i të akuzuarit av. F.Zh., përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. I.O., ndërsa në seancë nuk mori pjesë Prokurori i Apelit edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt, dhe seanca e kolegjit është mbajtur në mungesë të tij, për arsye se pjesëmarrja e tij nuk është e domosdoshme, e në pajtim me nenin 390 par.4 të KPP.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të PTH-DKR në Gjakovë, të mbrojtëses të akuzuarit, dhe të ankesës të akuzuarit P.N., të përfaqësuesit të palës së dëmtuar K.M., e sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 të KPP-së, e duke marrë parasysh edhe mendimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit DKR-në Prishtinë, pas shqyrtimit të gjitha shkresat e lëndës të kësaj çështje penale juridike dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Gjakovë dhe e përfaqësuesit të palës së dëmtuar janë të bazuara. ndërsa ajo e mbrojtëses të akuzuarit P.N. av F.Zh. refuzohet si e pa bazuar, dhe ankesa e vet të akuzuarit hudhet poshtë si e pa lejuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore DKR në Gjakovë pretendon se është bere shkelja e ligjit sa i përket vendimit mbi dënimin nga neni 387 par. 1 të KPRK, Prokuroria pretendon se dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 24 (njëzetekatër) vite ndaj të akuzuarit është dënim i ulët, pasi që nuk i përgjigjet përgjegjësisë penale të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë gjate shqiptimit të dënimit i ka vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese atë pranimin e fajit, pendimin e thellë të tij, ndërsa si rrethanë rënduese e ka vlerësuar shkallën e lartë të pjesëmarrjes në veprën penale dhe shkallën e dashjes për të kryer veprën penale. I akuzuari P.N. ka qenë njeri i dhunshëm ku edhe me parë ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij, dhe ai në momentin që ka shtëne me armë në drejtim të gruas së tij V. ka rrezikuar edhe jetën e personave të tjerë, pasi që aty kanë qenë te pranishëm edhe dy vëllezërit e saj nëna e sajë dhe fëmijët e te ndjerës, andaj prokuroria pretendon se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, me të cilin parashihet që ta parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij andaj me burgim të përjetshëm pretendojmë se do të arrihet qëllimi i dënimit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. I.O. pretendon se nga gjykata e shkallës së parë është bere shkelje në lidhje me vendimin mbi sanksionin penal, gjykata me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nga neni 74 dhe 79 të KPRK-së, si rrethane rënduese e ka vlerësuar vetëm faktin se vepra penale është kryer në prezencën edhe të personave të tjerë, gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë për bazë rrethanat posaçërisht rënduese siç janë, se i akuzuari P.N. është person i njohur për policinë, prokurorinë dhe gjykatën në Gjakovës ngase i njëjti disa herë me radhë kishte ushtruar dhunë kundër të ndjerës V.M. dhe për atë është dërguar në mbajtje të dënimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh, ku edhe me pas ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij tani të ndjerë, ai me të shtëne në gruan dhe vajzën e tij K. e ka rrezikuar edhe gjithë familjen e tij pasi që kanë qenë te pranishëm edhe fëmijët e tjerë në natën kritike, dhe në seancën e kolegjit ka përmirësuar propozimin për shkak të gabimit me shkrim dha ka propozuar që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit i shqiptohet dënimi i përjetshëm.

Mbrojtësja e të akuzuarit P.N. av. F.Zh. pretendon se aktgjykimi i atakuar është përfshire në shkelje ligjore në lidhje me vendimin mbi sanksionin penal dhe konsideron se vendimi për

dënimin nuk është i bazuar, se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, në mënyrë vullnetare se i akuzuari është penduar dhe tronditur thellë me veprimin që e ka bërë, se i akuzuari gjate kohës kur i është lexuar kërkesa për caktimin e paraburgimit pasi që e ka kuptuar që i është vrarë edhe vajza nga tronditja ka përjetuar shok traumatik, është rrezuar dhe është dashtë të ndërpritet seanca dëgjimore që ti ofrohet ndihma emergjente, që po i njëjti i ka humb dy anëtar të familjes, po ashtu i ka edhe katër fëmijë të tjerë, qëndrimi i të akzuarit ka qenë korrekt etj, gjykata e shkallës së parë si rrethanë renduese i ka vlerësuar se i akuzuari me dashje e ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij të ndjerë dhe vajzën e tij K., mbrojtja pretendon se i akuzuari nuk e ka pas për qellim ta privoj nga jeta bashkëshorten e tij mirëpo ai e ka marrë armen për çështje sigurie dhe ka shkuar për ta lutur gruan e tij që të kthehet pasi në shtëpi i kishte edhe 4 fëmijë të tjerë, mirëpo pasi që gruaja e tij nuk ka pranuar të kthehet i akuzuari viktimat i ka privuar nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore. Mbrojtja pretendon se edhe me në dënim me të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e PTH-DKR në Gjakovë, të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, si dhe të ankesave të mbrojtëses të akzuarit, të vet akzuarit, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas detyrës zyrtare, në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 të KPP-së, gjen se është shkelur ligji penal në dëm të akzuarit P.N., nga neni 385 par. 1 të KPP-së. Nga përkrahimi faktik i veprës penale nga neni 179 par. 1 nën par. 1.1, 1.3 dhe 1.11 të KPRK-së, objekti i aktgjykimin të ankimuar të përkrahur si në dispozitivin I. të aktgjykimin nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari ka shkuar në shtëpinë e vëllezërve të ndjerës V. për t'u marrë vesh që e ndjera V. të kthehet në shtëpinë e të akzuarit. Pasi që e ndjera në mënyrë kategorike nuk është pajtuar dhe nuk është arritur marrëveshja që ajo të kthehet në shtëpinë e të akzuarit P.N., i akuzuari duke dalë prej shtëpisë së vëllezërve të ndjerës V. i drejtohet me fjalë të pranishmëve "keni me ja ni krismën e kësaj pune". Dhe i akuzuari P.N., pasi që i kërcënohet me këto fjalë të ndjerës dhe vëllezërve të saj, ku kanë qenë prezent edhe anëtarët e familjes dhe fëmijët e të ndjerës V. fëmijët, përfshirë edhe të ndjerën K., i akuzuari shkron në shtëpinë e tij, merr pushkën automatike AK.47 dhe në mbrëmje kthehet në shtëpinë e vëllezërve të ndjerës V. që me dashje ta privojë nga jeta Valbonën, bashkëshorten e tij, e i akuzuari duke qenë i vetëdijshëm se në shtëpinë e vëllezërve të ndjerës V. ku paraprakisht ka qenë për tu marr veshë, që e ndjera Valbona-bashkëshortja e të akzuarit të kthehet në shtëpi, i akuzuari i vetëdijshëm për veprimet e tija, e ka ditur se në shtëpinë e vëllezërve të ndjerës V. është edhe e ndjera K. dhe anëtarët tjerë të familjes, dhe i akuzuari pasi që hynë në korridor të shtëpisë me pushkën automatike AK.47 me rafal shkrep dhe me atë rast me dashje i privon nga jeta bashkëshorten e saj - të ndjerën V. dhe fëmijën e saj të ndjerën K..

Nga kjo rezulton se i akuzuari në bashkim real me dashje kryen dy vrasje dhe për faktin se ai paraprakisht ka qenë në shtëpinë e vëllezërve të ndjerës V. dhe ka qenë i vetëdijshëm se në shtëpinë e vëllezërve të saj, përveç të ndjerës V. aty ka qenë edhe vajza e të akzuarit K., dhe i akuzuari me shkrepjen në rafal nga pushka automatike AK.47 ndaj të ndjerës V. ka shkrep, dhe i akuzuari ka mundur që shkrepjet nga pushka automatike AK.47 t'i kontrollojë, dhe ato kontrollohen,

mirëpo, i akuzuari, i vetëdijshëm për veprimet e tija me dashje e privon nga jeta të ndjerën V. dhe fëmijën e tij – vajzën K., e nga një përkrahje e këtyrë të ngjarjes, e cila ka ndodhur në shtëpinë e vëllezërve të ndjerës V. rezulton se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 1.11, për faktin se i akuzuari në bashkim real me vetëdije i ka kryer dy vrasje duke privuar nga jeta të ndjerën V. dhe fëmijën e tij – të ndjerën K. dhe me ricilësimin e veprës penale Gjykata e Apelit, ka evituar edhe shkeljen e ligjit penal nga neni 385 par. 1 të KPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit e duke vlerësuar ankesat e PTH-DKR në Gjakovë dhe të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, kjo gjykatë vlerëson se ankesat janë të bazuara. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, edhe pse nga shkresat e lëndës rezultojnë se i akuzuari P.N. ka pranuar fajësinë për veprat penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par. 1.1, 1.3 dhe 1.11 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, objekti i akuzës, edhe përkundër faktit se ekzistimi i veprave penale është i vërtetuar, me provat e pa kontestueshme të cilat gjenden në shkresat e lëndës, edhe pa pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar që pranimin e fajësisë e ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese. Mirëpo sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate rrethanat rënduese dhe posaçërisht rënduese nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe këto rrethana mbizotërojnë shumëfish me tepër, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, dhe shqiptimi i dënimit unik në kohëzgjatje prej 24 viteve nuk është adekuat me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarit, kjo për faktin se janë plotësuar kushtet ligjore se ekzistojnë ashtu rrethana posaçërisht rënduese dhe janë shkaktuar pasojat tejet të rënda me rastin e privimit nga jeta të bashkëshortes së tij V.N. dhe vajzës së tij K. N., e që kanë mund të shkaktohen edhe pasojat me të rënda. Siç rezultojnë nga shkresat e lëndës me rastin e privimit nga jeta të bashkëshortes dhe vajzës së tij, i akuzuari për shkak të raporteve të këqija bashkëshortore, e duke i marrë parasysh rrethanat personale të akuzuarit i cili tregon këmbëngulësi të fortë në privimin e jetës të bashkëshortes dhe vajzës së tij, ditën kritike në mëngjes pasi që vjen në shtëpinë e tani të ndjerës Valbona ku kanë qenë të pranishëm e ndjera Valbona bashke me tre fëmijët e sajë, nënën e sajë dhe dy vëllezërit e sajë dhe anëtarë tjerë të familjes dhe pasi që e ndjera V. e në prezencën e vëllezërve të sajë nuk pranon të kthehet prapë në shtëpinë e burrit të sajë të akuzuarit P., i njëjti duke dalë nga shtëpia iu benë me dije se do të privojë nga jeta, shkon në shtëpinë e tij e merr pushkën automatike AK 47, vjen në shtëpinë e të ndjerës V. dhe në korridorin e shtëpisë ka qenë prezentë e ndjerat V. dhe K., si dhe dy fëmijët e sajë bashke me anëtarët e tjerë të familjes, i akuzuari shkrep në rafal me pushkën automatike në drejtim të ndjerës Valbona dhe vajzës së tij K., e kjo këmbëngulësi e tij tregon karakterin personal të akuzuarit si rrethanë posaçërisht rënduese për të privuar nga jeta përveç bashkëshortes dhe vajzës së tij, edhe të anëtareve tjerë të cilët kanë qenë prezentë në korridor përfshirë edhe fëmijët e tij dhe me këtë rast janë shkaktuar pasojat tejet të rënda si objekt mbrojtës i veprës penale të vrasjes së rëndë, e që është jeta e njeriut si vlerë e mbrojtur me e madhe, e mbrojtjes penale juridike dhe në këtë mënyrë janë plotësuar të dy kushtet ligjore nga neni 44 për shqiptimin e dënimit të përjetshëm.

Përveç kësaj vepra penale e vrasjes së rëndë si objekt mbrojtës është jeta e njeriut si vlerë me e madhe me mbrojtjes penale juridike, se i akuzuari edhe me parë në mënyrë permanente ka pas sjellje të këqija ndaj bashkëshortes së sajë dhe familjes duke ushtruar dhunë, e duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale se ajo është kryer në prezencën e fëmijëve dhe vëllezërve të ndjerës V. si dhe anëtareve tjerë ku pasojat kanë mund të jenë edhe me të rënda, për shkak të mënyrës së kryerjes së veprës penale me shkrepje në rafal nga pushka automatike,

se ka pasë shqetësim të madh edhe tek qytetarët, Gjykata Apelit duke i vlerësuar rrethanat në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të akuzuarit ia ashpësoj dënimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 44 i KPRK-së, dhe e ndryshoj aktgjykimin dhe të akuzuarit për veprën penale të vrasjes së rënde nga neni 179 par 1. nën par 1.3 të KPRK-së ia shqiptoj dënimin e përjetshëm, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK ia shqiptoj dënimin në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, e në të cilat dënime i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 07.08.2018 e tutje, dhe në bazë të nenit 80 par. 2 nën par 2.1 të KPRK-së, dhe pse i akuzuari është shpallur fajtor për dy vepra penale Gjykata e Apelit ia ka shqiptuar vetëm dënimin e përjetshëm, e sipas sistemit të absorbcionit, e i cili është parapare me dispozitat e cekura me lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit dënimi i shqiptuar i përjetshëm është në proporcion edhe me peshën e veprave penale të kryera dhe me vlerën e mbrojtur, për faktin se veprat penale kundër jetës dhe trupit gëzojnë mbrojtjen më të lartë penale juridike, dhe dënimi i këfillë i shqiptuar i përjetshëm i përgjigjet peshës së veprës penale për arsye se i akuzuari ka treguar shkallë të lartë të në kryerjen e veprës penale, se gjithmonë një kohë të gjatë ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së sajë, e duke marrë parasysh se kemi pasojë të rënda dy viktime nënën dhe vajzën e sajë të privuar nga burri- prindi i akuzuari P.N., se kjo vepër penale ka shqetësuar edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se me shqiptimin dënimit të përjetshëm do të arrihet preventiva e përgjithshme dhe do të parandalojë edhe të tjerët nga kryerja e këtyre veprave penale dhe në tërësi pritet të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë si në nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar ankesën e mbrojtëses të akuzuarit P.N. av. F.Zh., vlerëson se ankesa është e pa bazuar. Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit nuk ka paraqitë asnjë rrethanë lehtësuese apo posaçërisht lehtësuese që kishte me ndikuar në zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit, edhe ato rrethana të cilat janë paraqitur si pranimit i fajësisë ato veç janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë.

Ankesën e të akuzuarit P.N. Gjykata e Apelit në bazë të nenit 400 e ka hedhur poshtë si të pa lejueshme për arsye se e njëjta nuk është e lejuar me ligj e në bazë të nenit e në bazë të nenit 383 par.2 se ankesa nuk mund të ushtrohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike në rastet kur i akuzuari ka pranuar fajësinë siç është rasti me të akuzuarin P.N. i cili në shqyrtimin fillestar në praninë e mbrojtëses ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat është shpallur fajtorë.

Nga ajo që u tha me lartë u deshtë që ankesat e PTH-DKR në Gjakovë dhe e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohen si të bazuara dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet në bazë të nenit 403 par. 1 të KPP-së, ndërsa ankesat e mbrojtëses të akuzuarit refuzohet si e pa bazuar dhe e të akuzuarit të hudhet poshtë si e pa lejuar e në bazë të nenit 401 dhe 400 të KPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.629/2018, me dt.31.01.2019

Procesmbajtësi,

Anëtarët e Kolegjit,

Kryetari i Kolegjit,

Sadik Kryeziu,

Fillim Skoro

Have Haliti

Xhevdet Abazi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka te drejtë ankese ne afat prej 15 ditëve pas pranimit të aktgjykimit, e cila ankesë do të paraqitet ne Gjykatën Themelore DKR në Gjakovë për Gjykatën Supreme të Kosovës.